



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 369/ prot.
3

Tiranë më 15.3.2018

VENDIM

Nr. 13, datë 15.3.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 369 Prot., datë 19.02.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Bashkisë Tiranë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 31.01.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

- 1. A ka Bashkia Tiranë një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane? Nëse po, vini në dispozicion një kopje të tij.*
- 2. Ku depozitohen mbetjet urbane?*
- 3. A ka Bashkia një marrëveshje apo kontratë me një kompani të caktuar (apo disa), e cila grumbullon mbetjet urbane? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Një kopje të kontratës së bashkëpunimit.*
- 4. A ka Bashkia një marrëveshje apo një kontratë bashkëpunimi me një kompani private e cila depoziton mbetjet dhe i përpunon ato? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Një kopje të kontratës së bashkëpunimit.*

5. *Sa kushton tarifa mujore për pastrim/gjelbërim që kanë paguar qytetarët në vitin 2015/2016/2017 dhe sa do të paguajnë në vitin 2018?*
6. *Sa i kushton bashkisë grumbullimi i mbetjeve urbane për një vit? Konkretisht për vitin 2015/2016/2017.*
7. *Sa është sasia vjetore e mbetjeve urbane në Bashkinë Tiranë (në ton dhe konkretisht për vitet 2015/2016/2017)?*
8. *Si trajtohen mbetjet e rrezikshme? Cili subjekt (ose subjekte) merret me përpunimin e tyre? A ka një marrëveshje bashkëpunimi mes bashkisë dhe kësaj kompanie? Nëse po, një kopje të kontratës me këtë kompani.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 369 Prot., datë 19.02.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 81 datë 02.03.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit është konstatuar se kërkesa e Z. është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe është regjistruar me nr. A - 2803 Prot., datë 01.02.2018. Nga ana e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, më datë 12.02.2018 kërkesa i është përcjellë për trajtim Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit. Nga ana e kësaj të fundit me anë të shkresës nr. A – 2803/1 Prot., datë 12.02.2018, praktika i është përcjellë për trajtim Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike si struktura përgjegjëse për zotërimin e informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit, Drejtori i Përgjithshëm i Punëve Publike sqaroi grupin e inspektimit se, kërkesa nuk është trajtuar brenda afatit ligjor për shkak të informacionit voluminoz të kërkuar dhe pas inspektimit të ushtruar do të kthehet një përgjigje në lidhje me kërkesën objekt inspektimi.

Grupi i inspektimit konstatoi se kërkesa për informacion nuk është trajtuar nga Autoriteti Publik brenda afatit të parashikuar në ligj.

Autoriteti Publik, pas inspektimit të ushtruar, me shkresën nr. A 2803/2 Prot., datë 02.03.2018, i ka kthyer përgjigje kërkuarit pjesërisht duke i sqaruar se: *Bashkia Tiranë akoma nuk e disponon një plan për Menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane.*

Pas shqyrtimit të ankesës, inspektimit të ushtruar si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Z. është informacion publik dhe si i tillë dhënia e tij nuk mund të refuzohet.

Konstatohet se Autoriteti Publik, edhe pas inspektimit të ushtruar, ka kthyer përgjigje vetëm për pikën e parë të kërkesës (*1. A ka Bashkia Tiranë një plan për menaxhimin e*

integruar të mbetjeve urbane? Nëse po, vini në dispozicion një kopje të tij), pa u shprehur në tërësi për 7 (shtatë) pikat e tjera të kërkesës. Duke e trajtuar në këtë mënyrë pjesërisht kërkesën për informacion.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Z. përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar. “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës për dhënien e informacionit dhe vënien në dispozicion të kërkuarit.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Z. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankimit nr. 369 Prot., datë 19.02.2018 të Z. kundër Autoritetit Publik “Bashkisë Tiranë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 31.01.2018,
 - *A ka Bashkia një marrëveshje apo kontratë me një kompani të caktuar (apo disa), e cila grumbullon mbetjet urbane? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë kenë që bashkëpunoni me të? Një kopje të kontratës së bashkëpunimit.*

- A ka Bashkia një marrëveshje apo një kontratë bashkëpunimi me një kompani private e cila depoziton mbetjet dhe i përpunon ato? Nëse po, cila është kjo kompani dhe sa kohë keni që bashkëpunoni me të? Një kopje të kontratës së bashkëpunimit.
- Ku depozitohen mbetjet urbane?
- Sa kushton tarifa mujore për pastrim/gjelbërim që kanë paguar qytetarët në vitin 2015/2016/2017 dhe sa do të paguajnë në vitin 2018?
- Sa i kushton bashkisë grumbullimi i mbetjeve urbane për një vit? Konkretisht për vitin 2015/2016/2017.
- Sa është sasia vjetore e mbetjeve urbane në Bashkinë Tiranë (në ton dhe konkretisht për vitet 2015/2016/2017)?
- Si trajtohen mbetjet e rrezikshme? Cili subjekt (ose subjekte) merret me përpunimin e tyre? A ka një marrëveshje bashkëpunimi mes bashkisë dhe kësaj kompanie? Nëse po, një kopje të kontratës me këtë kompani,

brenda datës 23 . 3 .2018.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 15 . 3 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

